



THIRRJE PËR PJESËMARRJE NË TRAJNIMIN ONLINE

Aplikoni në Trajnimin Online ARTE: **Arti për Europën – Fuqizimi i të rinjve përmes mundësive të BE-së**

- ❖ *A jeni ndërmjet moshës 18 dhe 30 vjeç dhe jetoni në Itali, Portugali, Greqi, Mal të Zi ose Shqipëri?*
- ❖ *A jeni të interesuar të mësoni më shumë rreth Bashkimit Evropian, të zbuloni mundësi mobiliteti dhe trajnimi, dhe të bëheni më aktivë në komunitetin tuaj lokal dhe evropian?*

Nëse po, **projekti ARTE** ju fton të bashkoheni në një **program trajnimi online falas**, i cili synon të fuqizojë të rinjtë përmes njohurive, pjesëmarrjes dhe shkëmbimit ndërkulturor!

Çfarë është ARTE?

ARTE – *Arti për Europën* është një projekt i financuar nga Programi CERV, i cili synon të bashkojë të rinj nga vendet e BE-së dhe vendet kandidate. Përmes një serie trajnimesh interaktive online, projekti promovon angazhimin qytetar, përfshirjen sociale dhe pjesëmarrjen kulturore.

Struktura dhe përmbajtja e trajnimit

Trajnimi online përbëhet nga **katër module interaktive**, të zhvilluara në **katër sesione të veçanta** çdo javë për një muaj me mundësi përzgjedhjeje ndërmjet muajve shkurt dhe maj 2026. Çdo sesion do të zgjasë rreth 2 orë dhe do të zhvillohet në **gjuhën angleze** përmes **platformës Zoom**.

Çdo pjesëmarrës pritët të marrë pjesë **në të katër sesionet**, të cilat së bashku përbëjnë programin e plotë të trajnimit. Pjesëmarrësit që i përfundojnë me sukses të katër modulet do të pajisen me një **Certifikatë Pjesëmarrjeje**.

Moduli I – Hyrje në Bashkimin Evropian dhe Politikë Rinore

- Historia dhe zgjerimi i BE-së, institucionet kryesore dhe momentet kyçe legislative
- Strategjia Rinore e BE-së 2019–2027, Axhenda Evropiane për Punën Rinore, Objektivat Rinore
- Konferenca për të Ardhmen e Evropës dhe angazhimi i të rinjve në hartëzimin e politikave të BE-së

Moduli II – Procesi i Anëtarësimit në BE dhe Praktikë më të Mira

- Hapat dhe procedurat në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian
- Iniciativa **New European Bauhaus (NEB)**
- Shembuj frymëzues të bashkëpunimit ndërkufitar dhe nismave rinore të financuara nga BE-ja



Co-funded by
the European Union



Moduli III – Mundësitë e Mobilitetit dhe Financimit të BE-së për të Rinj

- Pasqyrë e thirrjeve të programit Erasmus+ dhe skemave të mobilitetit rinor
- Programe trajnimi dhe shkëmbimi, aktivitete për pjesëmarrjen rinore, DiscoverEU
- Punëtori praktike mbi hartimin dhe shkrimin e projekteve bazuar në thirrje të hapura

Moduli IV – Njohja e Mësimi dhe Punës në BE

- Youthpass dhe njohja e rezultateve të të nxënës joformal
- Këshilla ligjore dhe praktike për studim dhe punë në vendet e BE-së
- Strukturat mbështetëse: Europe Direct dhe shërbimet e këshillimit për të rinjtë

Çdo sesion përfshin diskutime interaktive, prezantime nga ekspertë dhe mundësi shkëmbimi me bashkëmoshatarë nga pesë vende të ndryshme.

Kush mund të aplikojë?

Pjesëmarrësit duhet të:

- Jenë ndërmjet moshës 18 dhe 30 vjeç
- Të banojnë në Itali, Portugali, Greqi, Mal të Zi ose Shqipëri
- Të jenë të motivuar për t'u angazhuar në temat evropiane dhe pjesëmarrjen rinore

Si të aplikoni?

Plotësoni formularin e regjistrimit online: <https://forms.gle/7K98osgK3qSLdL4w7>

Afatet për dërgimin e aplikimit tuaj:

- **23 shkurt 2026** nëse dëshironi të merrni pjesë në sesionin e parë që fillon më **27 shkurt**
- **23 mars 2026** nëse dëshironi të merrni pjesë në sesionin e dytë që fillon më **27 mars**
- **04 maj 2026** nëse dëshironi të merrni pjesë në sesionin e dytë që fillon më **8 maj**

Kontaktoni për më shumë informacion:

- Planifikimi Strategjik, Bashkia Shkodër – planifikimistrategjik@bashkiashkoder.gov.al

Presim me kënaqësi t'ju bashkoheni komunitetit tonë evropian të të mësuarit!

